



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 43 datë 28.05.2025

PËR

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “GODINA BANIMI,
GODINË SHËRBIMESH, ME 1, 2, 3 KATE MBI TOKË ME 1 KAT NËNTOKË ME
PISHINA DHE KOPËSHT ÇERDHE E PARK LOJRASH PËR FËMIJË DHE MUR
RRETHUES”, ME VENDNDODHJE NË LUNDËR, BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Qazimi Invest” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Godina banimi, godinë shërbimesh, me 1, 2, 3 kate mbi tokë me 1 kat nëntokë me pishina dhe kopësht çerdhe e park lojrash për fëmijë dhe mur rrethues”, me vendndodhje në Lundër, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Qazimi Invest” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuarit vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 23/01/ 2026